



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MIRDITË

AGJENCIA E PUNËVE PUBLIKE DHE MIRËMBAJTJES, BASHKIA MIRDITË

Nr. _____ Prot.

Rreshen, më _____.2021

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Drejtuar: Bashkimit të Operatorëve Ekonomik: “ALIAJ-79” Sh.p.k., me numër Nipt-i: L47521901E, me seli: Dibër, Lis, Zenisht, rruga “Ruçi”, Ndërtesë private 1-katëshe përballë xhamisë, dhe “UDHA” Sh.p.k., me numër Nipt-i: K77524909Q, me seli: Dibër, Burrel, Lagjia “Pjeter Budi”.

Procedura e prokurimit: “E Hapur - Mallra”, – Marrëveshje Kuadër – me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

Numri i referencës së procedurës: REF-04541-09-03-2021

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje materiale ndërtimi, hidraulike, elektrike dhe shërbimi, për Agjencinë e Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes, bashkia Mirditë”, me fond limit/ vlera e pritshme e kontratës: 27 751 260 (njëzet e shtatë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e një mijë e dyqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, me afat realizimi: viti 2021, 2022, 2023.

Publikime të mëparshme: nuk ka patur

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 136, datë 13 Shtator 2021

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik: “ALIAJ-79” Sh.p.k., me numër Nipt-i: L47521901E, dhe “UDHA” Sh.p.k., me numër Nipt-i: K77524909Q,

Vlera e ofruar: 27 130 835 (njëzet e shtatë milion e njëqind e tridhjetë mijë e tetëqind e tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH

2. Operatori Ekonomik: “MURATI D” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **K42003004T**

Vlera e ofruar: **23 831 850** (njëzet e tre milion e tetëqind e tridhjetë e një mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik: “MURATI D” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **K42003004T**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtëm:

❖ Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “MURATI D” Sh.p.k., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Përzgjedhjes/ Kualifikimit, si më poshtë:

I. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 1 gërma “a” / 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

“1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8...”

➤ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se në *Formularin Përmbledhës të vetëdeklarimit:*

1. Nuk është plotësuar saktë seksioni A “*Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit*”;

2. Nuk është plotësuar saktë seksioni B “*Deklaratë për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme*”.

II. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.2/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.2 *Për Listën e mallrave/ materialeve të përcaktuara në Preventivin objekt prokurimi sipas dimensioneve të kërkuara në preventivin dhe Specifikimeve teknike, listën si më poshtë:*

- *Pllaka trotuari të ndryshme*
- *Bordura trotuari të ndryshme*
- *Tub betoni*
- *Tub i brinjëzuar me 2 shtresa “HDPE” SN4*
- *Shtylla metalike konike ndriçimi h=7*
- *Ndriçues led për ndriçim rrugor 100 w*

Operatori ekonomik duhet të paraqesë: *Autorizim të prodhuesit/ve ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të*

zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave lëshuar/ lidhur jo më parë se data e publikimit të procedurës së prokurimit. Autorizimi/ Marrëveshja bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, dhe të jetë e vlefshme vetëm për këtë objekt deri në realizimin e plotë të punimeve.

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se:**
- 1. Shoqëria “ELAL Com” nuk rezulton që të jetë prodhuese e materialeve *Shtylla metalike konike ndriçimi h=7, dhe Ndriçues led për ndriçim rrugor 100 w*, por ushtron aktivitetin e furnizimit dhe implementimit të këtyre materialeve.**
 - 2. Autorizimi i Distributorit “Alba Elettrica” Sh.p.k., është lëshuar përpara datës së publikimit të kësaj procedure prokurimi, nuk i referohet këtij objekti prokurimi, si dhe nuk është paraqitur Autorizimi/ Marrëveshja etj, i prodhuesit/ve për distributorin “Alba Elettrica” Sh.p.k., që të tregojë lidhjen ndërmjet Autorizuesit dhe distributorit.**
 - 3. Autorizimi i Prodhuesit për mallrat (materialet): pllaka trotuari, bordura trotuari dhe tub betoni, nuk përmban të dhënat e plota të prodhuesit si: tel., fax, e-mail, website etj., kërkuar si kusht nga A.K.**

III. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.5/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë një numër minimal prej 5 (pesë) punonjësish të punësuar, ndër të cilët 1 (një) shofer për transportin e mallit, të cilët duhet të rezultojnë në listëpagesa për periudhën 3 (tre) muajt e fundit, ku në rast se shpallet fitues, për vërtetimin e këtij kushti përpara nënshkrimit të kontratës, të paraqitet sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 të DST-së, dokumentacioni: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme; Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore, si dhe leje për drejtimin e mjetit kategoria C, të punonjësit me detyrë “shofer” në rast se mjeti është në pronësi të operatorit ekonomik ofertues, në të kundërt në rast se mjeti është me qera të paraqitet kontrata e punës individuale e punonjësit me profesion “shofer”.

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se:**
- 1. Nuk janë paraqitur listëpagesat për periudhën 3 (tre) muajt e fundit, për vërtetimin e disponimit të punonjësve që kërkohen për ekzekutimin e kontratës, pasi emrat e tyre nuk janë vetëdeklaruar dhe në shtojcën 8 e paraqitur.**
 - 2. Për punonjësën me detyrë “shofer” paga e përcaktuar në Kontratën e punës (noteriale) vjen në kundërshtim me VKM-në Nr.1025, datë 16.12.2020 “Për Përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”.**

IV. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.6/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.6 *Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 1 (një) Kamion me vinç - mbi 7 ton, me qëllim transportin e mallrave, të cilin duhet ta ketë në pronësi, huapërdorje ose me qira, dhe për të cilin në rast se shpallet fitues, për vërtetimin e këtij kushti përpara nënshkrimit të kontratës, të paraqitet sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 të DST-së, dokumentacionin përkatës, si më poshtë:*

a) *Dokument që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen si më poshtë:*

➤ *Dokumentacioni që vërteton pronësinë:*

- *Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose kontrata e shitblerjes; ose kontrata e dhurimit; ose çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.*

➤ *Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:*

- *Kontratë huaje.*

➤ *Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:*

- *Kontratë qiraje.*

b) *Leje qarkullimi e mjetit.*

c) *Çertifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore,*

d) *Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve,*

e) *Çertifikate për transport mallrash.*

➤ **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk vërtetohet disponimi i kamionit me vinç, pasi referuar Çertifikatës Nr.009, datë 15.10.2020 “Për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit” lëshuar nga Bashkia Kamëz, për Kamionin e marrë me qera, marka DAF, me targa AB 405 BD, rezulton se është në përdorim të personit juridik “SILBORA” Sh.p.k., dhe jo në emër të operatorit ekonomik pjesëmarrës “MURATI D” Sh.p.k., apo në emër të qiradhënësit, dhe se këto të fundit nuk kanë paraqitur një të tillë.**

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si të suksesshëm:

1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik: “ALIAJ-79” Sh.p.k., me numër Nipt-i: L47521901E, dhe “UDHA” Sh.p.k., me numër Nipt-i: K77524909Q,

Vlera e ofruar: **27 130 835** (njëzet e shtatë milion e njëqind e tridhjetë mijë e tetëqind e tridhjetë e pesë) **lekë pa TVSH**

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “*Për Prokurimin Publik*”.

Titullari i Autoritetit Kontraktor